



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/ Nr. 354/2022
Datë: 11 mars 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 7 paragrafi 7 të Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Aprovohet tërheqja e z. Arben Ismajli prokuror në Prokurorinë e Apelit nga kandidatura për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, dorëzuar me datë 11 mars 2022.
- II. Plotësohet dhe ndryshohet paragrafi I pika 1 e Vendimit KPK/Nr.277/2022 i datës 15 shkurt 2022 për konfirmimin e statusit të kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- III. Konfirmohet lista përfundimtare e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, si në vijim:
 1. Armend Hamiti, prokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
 2. Blerim Isufaj, Kryeprokuror në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;
 3. Kujtim Munishi, Kryeprokuror në Prokurorinë Themelore në Prishtinë;
 4. Lulzim Sulejmani, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit; dhe
 5. Shqipdon Fazliu, prokuror në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.
- IV. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në ueb portalin e sistemit prokurorial të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës me Vendimin KPK/Nr.277/2022 të datës 15 shkurt 2022, ka konfirmuar statusin e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kriteret për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Me datë 11 mars 2022, kandidati Arben Ismajli, prokuror në Prokurorinë e Apelit, përmes e-mailit zyrtar ka njoftuar anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës se pas pranimit të opinionit nga Agjencionin Kundër Korrupsion ka vendosur që të tërheq kandidaturën për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Andaj, duke u bazuar në të lartë thënat si dhe në legjislacionin në fuqi, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet :

- Z. Arben Ismajli, prokuror në PA;
- Sekretariatit të KPK-së;
- Arkivit të KPK-së;